



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**  
***Sesioni pranveror***

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **39**

Prishtinë, më 2.4.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Sergjan Mitroviq, Liburn Aliu, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Andin Hoti, Salih Zyba, Danush Ademi dhe Lutfi Zharku.

Munguan: Etem Arifi dhe Besa Gaxherri.

Të ftuar: Fatmir Matoshi, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Arben Çitaku, sekretar i përgjithshëm, Sevdije Lama dhe Leutrim Sahiti, këshilltarë, Fatmir Gërguri, kryeinspektor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Selvete Grajçevci-Pllana, kryesuese e Departamentit Ligjor.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

*Rendi i ditës*

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të Komisionit nga mbledhja e mbajtur më 14.3.2019;
3. Informimi i Komisionit në lidhje me hidrocentralet dhe gurthyesis; ( i ftuar ministri i MMPH-së dhe zyrtarët e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale).
4. Të ndryshme.

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 14.3.2019;**

Kryetari, konstatoi se me 7 vota për, miratohet procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 14.3.2019, me plotësimin e deputetit **Salih Zyba**, me një pyetje plotësuese për sekretarin e MBPZHR-së: *“a është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore për rastin apo për shqetësimet që kanë qenë në opinion ?”*

### **3. Informimi i Komisionit në lidhje me hidrocentralet dhe gurthyesit(i ftuar ministri i MMPH-së dhe zyrtarët e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale).**

**Kryetari**, fillimisht i përshëndeti dhe i falënderoi për pjesëmarrje në mbledhje, ministrin e MMPH-së, Fatmir Matoshi dhe kryesinpektorin e KPMM-së, Fatmir Gerguri, duke paraqitur disa shqetësime të banorëve nga gurëthyesi i fshatit Qirez, të cilët ta i kemi vizituar dhe jemi njoftuar për shqetësimet e tyre, e që janë shumë serioze. Gjithashtu, i kemi takuar edhe pronarët e gurëthyesit dhe kemi konstatuar se aty ka disa probleme që mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve, prandaj, shtoi ai se i kemi ftuar personat kompetentë për të na dhënë informacione në lidhje me këtë problem.

**Ganimete Musliu**, propozoi që përveç hidrocentraleve dhe gurëthyesit, ministri në bazë të informacioneve që ka nga terreni, të njoftojë në lidhje me zjarret e shumta në pyje, sepse gjendja është alarmante.

**Fatmir Matoshi, ministër**, në fillim tha se informacionin rreth problemeve në gurëthyesin në Qirez e ka marrë nga mediat e pastaj nga deputetja Ganimete Musliu, me të cilën i kemi taku disa përfaqësues të fshatit Qirez dhe jemi njoftuar me hallet e tyre. Në lidhje me gurëthyesit, MMPH-ja monitoron tri aspekte: ndotjen e ajrit, degradimin e tokës dhe ndotjen e ujërave. Çështjet tjera që kanë të bëjnë me sigurinë, që janë ngritur nga banorët gjatë kohës së minimumit, nuk i përkasin MMPH-së dhe janë tema që i trajtojnë institucione tjera si: KPMM-ja, Ministria e Punëve të Brendshme. Në këtë zonë ka pasur disa gropa të mbushura me ujë, që kanë paraqitur rrezik për banorët dhe sipas inspektimit të djeshëm, këto gropa kanë filluar të mbyllën nga operatori, i cili posedon pëlqim mjedisor nga MMPH-ja. Për dukurinë e djegies së pyjeve, tha se është shumë i shqetësuar dhe përveç kontakteve me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencinë për Menaxhimin Emergjencave, Agjencinë e Pyjeve, Komunitat, ministria nuk ka kompetencë të drejtpërdrejtë në menaxhimin e kësaj situate dhe as të pyjeve. Megjithatë, me aprovimin e Udhëzimit administrativ për ndëshkim me gjoba mandatore, i mundësohet inspektorëve të ndëshkojnë djegësit e hamulloreve deri në 100 €, e që ndërlihet me ndotjen e ajrit.

**Ganimete Musliu**, përveç mbylljes së gropave, pyeti se cilët janë hapat konkretë që ka ndërmarrë ose që do t'i ndërmarrë Ministria, konform kompetencave që ka dhe cilat kanë qenë rekomandimet e inspektorëve nga terreni. Ajo në vazhdim tha se problemi i gurëthyesit në Qirez, është i mëhershëm dhe se këtë shqetësim e ka ngritur edhe me ish- ministren e MMPH-së, ndërsa sot është bërë lajm medial dhe se ky duhet të jetë një alarm për të gjitha institucionet përgjegjëse sepse nuk guxojmë të heshtim para një rreziku që i kanoset banorëve të Qirezit, por edhe vendeve tjera, pasi që kemi parë gurë që kanë fluturuar mbi shtëpi.

**Ministri**, tha se gjendja që kanë parë inspektorët, është se operatori e ka rrethuar me tela gjemborë hapësirën ku operon. Pas ankesave është mbyllur një gropë që paraqiste rrezik për banorët. Brenda territorit ku operon gurëthyesi është vërejtur cisterna për spërkatjen e terrenit kundër pluhurit, po ashtu, operatori është urdhëruar t'i përmbahet me përpikëri kushteve mjedisore që i ka marrë nga Ministria dhe se operatori do të jetë në mbikëqyrje të vazhdueshme.

**Liburn Aliu**, duke u ndërlidhë me fjalën e ministrit se “operatori posedon pëlqim mjedisor”, pyeti nëse operatori është dashur të pajiset me leje mjedisore dhe nëse shikohet edhe degradimi dhe ndikimi në ujëra, a është dashur të ketë leje të integruar. Pastaj, për eksploatimin e zhavorrit në lumenj, pasi që përmendi se Komisioni në periudhën 2012- 2013, e ka monitoruar zbatimin e ligjit të VNM-së dhe VSM-së dhe asokohe është vërejtur se eksploatimi i lumenjve ka qenë tepër alarmant dhe që prej asaj kohe eksploatimi vazhdon dhe nuk ka ndryshuar. Aliu pyeti se a kanë pëlqime dhe leje mjedisore këta operatorë dhe nëse nuk kanë, pse nuk u ndalohe puna?

Duke përmendur disa raste të lejeve të integruara mjedisore për Ferronikelin, Rafinerinë në Lipjan, Sankovc, etj, pyeti se a duhet të kenë këto edhe leje ujore për shfrytëzim dhe shkarkim të ujërave të ndotura dhe a duhet të ketë leja e integruar në vete edhe lejen ujore?

**Ministri**, për leje të integruar, tha se duhet të ketë një debat më të gjerë, ndërsa pëlqimi mjedisor atyre ua mundëson fillimin e punës me kusht që në fund t'a bëjnë rikultivimin.

Për eksploatuesit e zhavorrit, tha se është shqetësuese degradimi i lumenjve, dhe se për këtë duhet një mobilizim më i madh, pasi që këta punën e bëjnë natën edhe vikendeve. Për këtë, ai përmendi një aksion të ndërmarrë ditëve të fundit, së bashku me Policinë dhe KPMM-në.

**Arben Çitaku**, tha se procedurat teknike janë të rregulluara me ligj dhe se dallojnë cilët operatorë duhet të pajisen me ‘*leje mjedisore*’ dhe cilët me ‘*leje të integruar mjedisore*’. Gurëthyesit nuk hyjnë në kategorinë që duhet kërkuar ‘*leje të integruar mjedisore*’. Ata pajisen vetëm me ‘*leje mjedisore*’. Paraprakisht ata pajisen me ‘*pëlqim mjedisor*’, i cili paraqitet në bazë të një projekti dhe duhet theksuar se asnjë pëlqim mjedisor nuk lëshohet pa e pasur paraprakisht pëlqimin e Kuvendit Komunal dhe pa procedurën e debatit publik, i cili zgjatë 20 ditë dhe më pas shpallet në një gazetë nacionale, ueb faqen e Ministrisë dhe në tabelën e shpalljeve të komunës prej nga vjen ajo.

Sipas Inspektoratit të MMPH-së, janë 112 gurore aktive dhe 25 prej tyre i kemi në procedura gjyqësore. Ndërsa, sqaroi se në kuadër të ‘*lejes së integruar mjedisore*’ janë të integruara të gjitha lejet të cilat obligohen operatorët ekonomikë t’i kenë. Për detajet teknike, për secilin rast konkret i ftoj të kenë takime të tjera dhe të gjitha informacionet janë publike dhe të qasshme.

**Salih Salihu**, tha se, që nga paslufta nuk është vërejtur ndikimi i Ministrisë për parandalimin e degradimit të ambientit në përgjithësi dhe pyeti sa është duke kontribuar Ministria për mbrojtjen e ambientit të cilën e ka përgjegjësi? Pastaj, tha se është paradoksale, që pasi të jepet pëlqimi mjedisor, operatori fillon me shkatërrimin e ambientit dhe si pasojë, sot gjithkund nëpër Kosovë shihen “*kodrat janë bërë zgavra që donë me i përpi fshatrat*”. A ka strategji Ministria për këtë problematikë? Në kuadër të kësaj, ai përmendi shembullin e Austrisë, ku për shfrytëzimin e zhavorrit, kanë hapur gropa në sipërfaqe të rrafshëta, pastaj ato i kanë shndërruar në liqene akumuluese artificiale për rekreacion.

Në fund pyeti, sa gjoba janë shqiptuar në vitin 2018 ndaj operatorëve që shfrytëzojnë zhavorrin në kodra dhe lumenjve?

**Ministri**, u përgjigj se nuk është gjendja në terren ajo që e dëshirojmë dhe potencoi fazat për marrje të pëlqimit mjedisor, duke u ndalur te debatet publike me banorët. Nëse ka gurore për të cilën nuk është përfillur kriteri i debatit publik me qytetarët e lokalitetit ku operon, atëherë ne si Ministri marrim përgjegjësi. Është një procedurë që përfshinë shumë aktorë, siç janë: komuna, qytetarët, KPMM-ja që jep licencë dhe sot askush nuk e drejton gishtin kah Komuna që e ka dhënë pëlqim në territorin e vet. Në Ministri ankohen banorët ku në zonat e tyre janë mbajtur dëgjimet publike, për me hy në funksion këta operatorë. Prandaj, nuk është e drejtë të kërkohet një fajtor në mesin e shumë aktorëve që kanë përgjegjësi e kompetenca?

**Salih Zyba**, tha se ka qenë insistim i tij i vazhdueshëm, kërkesa për këtë debat edhe para rastit të Qirezit, sepse gjendja në përgjithësi është e rëndë edhe në vende të tjera dhe për këtë ai kërkoi një vëzhgim të përbashkët me ministrinë në terren për të konstatuar gjendjen.

Për djegien e pyjeve, tha se nëse pyjet nuk janë në kompetencë të Ministrisë, atëherë me siguri ndotja e ajrit është dhe pyeti sekretarin se cili është organi që mbikëqyrë, në rast se komunat e kanë tejkualuar apo shkelur këtë proces.

Zyba pyeti, se a janë duke punuar këta 25 gurëthyes që janë në procese gjyqësore dhe a ka më shumë se 112 gurëthyes që operojnë, pasi që është përgjegjësi e kësaj ministrie. (*Arben Çitaku e dorëzoi listën e operatorëve*).

**Ministri**, tha se e mirëpret idenë e deputetit Salih Zyba dhe shpresat për ta ndryshuar këtë gjendje i kemi te Komisioni parlamentar dhe ne si ministri jemi të gatshëm të dalim së bashku në terren dhe se çdo dokumentacion që e kërkoni në lidhje me këtë temë, do ta keni në dispozicion.

**Kryetari**, tha se Qirezi ka qenë shkas për këtë raportim në Komision. Ne kemi pasur takime me banorët dhe shqetësimet e tyre janë të tmerrshme. Ata kanë vërejtje konkrete për ndotjen e ujit, pluhur të madh, dridhjet, zhurmat. Atje kemi parë gurë të mëdhenj në oborre të shtëpive. Propozoi që të formohet një komision i ministrisë që do të bëjë matjet e ndotjes së ujit, ajrit, zhurmës dhe të merret një përgjigje e saktë se çka po bën ky gurëthyes.

**Ministri**, tha se ka filluar një vëzhgim i rregullt nga inspektorati i MMPH-së. Po i rishikojmë a janë zbatuar të gjitha procedurat kur është dhënë pëlqimi mjedisor. Në rast se ka pasur shkelje, raporti do të jetë publik. Pas këtij vëzhgimi kemi mundësi të marrjes së masave dhe në rast se nuk ka përmirësim të situatës, mund të bëhet edhe tërheqja e pëlqimit mjedisor.

**Liburn Aliu**, diskutoi për pëlqimin mjedisor për kompaninë 'Contour Global'. Ai tha se nuk pajtohet me përmbajtja e tij, dhe duke cituar disa fjalë nga ky pëlqim: "të përgatitet dhe zbatohet plani për aksidentet mjedisore", "të ndërtohet impianti i trajtimit të ujërave të shkarkuara", "të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i ujërave të shkarkuara", etj, dhe tha se këtu flitet në terma të përgjithshëm dhe është aq i përgjithshëm si një letër informuese. Për këtë duhet të ketë vlerësim konkret në elaboratin e përgatitur paraprakisht. Prandaj, vazhdoi ai, gurëthyesi në Qirez mund të themi se ka pëlqim mjedisor, por nëse ka kesi pëlqimi si 'Contour Global', e ka hapësirën e mjaftueshme të veprimit.

**Arben Çitaku**, për 'Contour Global' tha se këto janë kushte të cilat bazohen në një dokumentacion voluminoz dhe për secilin rast ekziston dosje e veçantë në ministri. Ajo që shkruan këtu, rrjedh nga një projekt i detajuar dhe i shqyrtuar nga ekspertë të fushës, vendorë dhe ndërkombëtarë.

Termocentrali, tha se akoma nuk është ndërtuar dhe ne lëshojmë kushtet mjedisore mbi bazën e një projekti të cilin e dorëzon kompania dhe ne i vendosim standarde që janë të aplikueshme në Kosovë dhe që i kanë të integruara të gjitha direktivat e BE-së brenda tyre.

**Liburn Aliu**, tha se pëlqimi është hap i rëndësishëm para lejes ndërtimore dhe leja mjedisore jepet në fund kur të fillon operimi, dhe atëherë është vonë. Prandaj pëlqimi mjedisor bëhet mbi bazën e një elaborati dhe para tij duhet dhënë këto kushte.

**Arben Çitaku**, sqaroi se pëlqimi mjedisor është hapi i parë drejtë fillimit të ndërtimit të një projekti dhe pastaj i nënshtrohet edhe procedurave tjera, në rastin konkret ka edhe lejet për ujë, lejet ndërtimore, dhe në fazën testuese pasi të fillojë operimi i nënshtrohet lejes së integruar mjedisore. Pëlqimi mjedisor bazohet mbi bazën e një elaborati profesional dhe të shqyrtuar nga ana e eksperteve dhe pastaj përgatitet ky vendim.

**Fatmir Gerguri**, kryeispektor i KPMM-së, për informim tha se në vitin 2017 dhe 2018, janë rreth 7 milion kg. eksploziv të përdorur për minime masive, ose 1174 minime masive në krejt këtë aktivitet minierar, të cilin e përcjellë inspektorati i KPMM-së dhe nuk e kemi edhe më të voglin aksident, kurse incidente si rasti i Qirezit ka mundur të ndodhë. Gurorja ERT-i në Qirez, ka licencë për veprim, minimi ka ndodhur më 18 mars 2019. Njoftimi për aksidentin është bërë më 19 mars 2019, dhe pas njoftimit kemi krijuar komision profesional të profileve të kësaj fushe: një xehetar inxhinier minierash, gjeolog minierash dhe një gjeodet, që ka bërë matjet dhe arsyetim teknik të mjaftueshëm nuk ka, se si arriti deri te një guri me përmasa mbi 200 kg. në një gjatësi prej 350 metra. (*Raportin, tha se do ta dërgojë me e-mail*).

**Kryetari**, pyeti se a janë gurët e gjetur në shtëpitë e banorëve, nga shpërthimi i kësaj guroreje? Nëse po, atëherë a është e mjaftueshme që të fillohet procedura për tërheqjen e licencës dhe se kush e mban përgjegjësinë për aksidente të tilla?

**Fatmir Gerguri**, u përgjigj se edhe pse duket e pamundur, gurët janë nga ajo gurore. Ky është incident dhe janë marrë masat si, pezullimi i aktivitetit minues të minandezësit dhe ai është përgjegjës për pasojat që ndodhin rreth atij minimi. Përgjegjësia drejtpërdrejtë bie mbi kompaninë minuese dhe ndërmarrjen që minon.

**Ganimete Musliu**, pyeti se cila është sasia maksimale e lejueshme dhe normale e eksplozivit në këso raste si në Qirez dhe a është tejkalluar kjo sasi në këtë rast dhe nga kjo ka ardhur deri te pasojat? Ndërsa, për gurin e madh që ka fluturuar te banorët, kërkoi ekspertizë profesionale të saktë. A është takuar KPMM-ja me banorët dhe si është trajtuar halli i tyre? Për gjendjen e gurëthyesve në veri të Mitrovicës, pyeti se a inspektohen ata dhe sa gurëthyes janë.

**Fatmir Gerguri**, tha se KPMM-ja ka qenë e thirrur për një raport profesional, ndërsa kemi lënë hapësirë që përmes forenzikës të caktohet saktësisht se si një gur i tillë ka fluturuar. Në të gjitha

analizat teknike që janë bërë për minim, rrezja e sigurisë nuk kalon 100 metra. Për sasinë e përdorur të eksplozivit, tha se janë përdorur 4750 kg. Eksploziv, ndërsa shtoi se nga 36 minime deri sot që janë bërë në Qirez, s'ka pasur asnjë aksident. Ne e kemi një inspektor në veri në Leposaviq, i cili na informon dhe se gurore aktive nuk ka në pjesën veriore.

**Liburn Aliu**, pyeti po të ishte kjo ngjarje me fatalitet në njerëz a do të mbyllej ky gurëthyes dhe shtoi se nëse nuk merren masa tash, mund të përsëritet kjo.

**Fatmir Gerguri**, tha se në raste të tilla merren masa për parandalimin. Nuk lejohet minimi i radhës, pa marrjen e masave konkrete, fjala vjen, kufizohet lënda eksplozive gjatë minimeve, behën matjet e valëve sizmike nga një institucion i licencuar, kompania duhet të sigurojë mbrojtjen e shëndetit dhe jetën e njerëzve.

**Salih Salihu**, pyeti se cilat janë masat që do ti ndërmerrni në lidhje me këtë incident?

**Fatmir Gerguri**: Masat konkrete janë pezullimi i licencës së e minandezësit për 6 muaj dhe pezullimi i aktiviteteve minuese për guroren në fjalë.

**Salih Zyba**, tha se puna e juaj është e lidhur ngushtë me inspektorët e punës dhe pyeti se cilat janë masat që i ndërmerrni për parandalimin e rrezikut të vdekjes, sepse kemi incidente në vendet e punës në gurëthyes dhe cilin gurëthyes e keni mbyllur me pretekst të parandalimit të këtij rreziku dhe nuk janë marrë masa dhe në fund pyeti a ka një gurore ku në fund është kthyer gjendja e mëparshme, siç është e përcaktuar me ligj dhe çka është ndërmarrë për ata që s'e kanë kryer këtë obiligim?

**Fatmir Gerguri**, tha se, ne marrim masa për mbrojtjen e punëtorëve që na takojnë, ndërsa, për punën e inspektoratit, tha se 70 % e kohës e marrin operuesit ilegalë, një prej tyre është edhe nxjerrja ilegale e qymyrit në Obiliq. Ai tha se ka pasur 90 inspektime në 2 javët e fundit, dhe jemi në bashkëpunim me MMPH-në, Policinë, Inspektoratin e pyjeve dhe inspektorët komunalë. Aktualisht jemi në këtë aksion dhe i kemi në vëzhgim 3 komuna: Gjakovën, Rahovecin dhe Malishevën, pastaj edhe komunat e tjera. Ka gurore që e kanë kryer aktivitetin e shfrytëzimit dhe kanë kryer rikultivimin në nivelin më të mirë. Kemi gurore që nuk e kanë kryer rikultivimin dhe për këtë janë ndalë garancitë bankare. Për njoftim, tha se në projektin për shfrytëzim bashkëngjitet edhe projekti i rikultivimit dhe garancia bankare për të siguruar se do të kryhet ky proces.

**Kryetari**, propozoi që për temën e hidrocentraleve të merret një informacion bazë nga ministri dhe mos të debatohet sot, por të trajtohet në një prej mbledhjeve të ardhshme.

**Liburn Aliu**, në lidhje me këtë, propozoi që përveç temës së hidrocentraleve të diskutohet për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ujërat, për lejet ujore, pëlqimet ujore, master planin e ujërave dhe strategjinë e ujërave.

**Salih Zyba**, pyeti ministrin për kohën kur do të procedohet në Kuvend, Raporti për gjendjen e mjedisit, duke potencuar vonesat në miratimin e raportit të vitit 2017.

**Ministri**, informoi shkurt, se janë 7 hidrocentrale aktive dhe në procedurë janë edhe 63 të tjera, ndërsa nuk ka leje dhe pëlqime të dhëna përgjatë viteve 2018 dhe 2019. Ndërsa, Raporti për gjendjen e mjedisit për vitin 2018, tha se në muajin maj do të jetë i gatshëm. Ai shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe për të trajtuar të gjitha temat së bashku.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetari i Komisionit,  
**Muharrem Nitaj**